



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 151 Datë 12.11.2012

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ
SHOQËRISE CEZ SHPËRNDARJE SH.A**

Në mbështetje të nenit 64 pika 1, gërma “dh”, dhe “gj” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” dhe neneve 5 dhe 6 e në vazhdim të “Rregullores për vendosjen e gjobave dhe kushteve të lehtësimit prej tyre”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE, nr. 101, datë 19.07.2012, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

CEZ shperndarje ka kryer shkelje te Kontrates se Furnizimit me Energji Elektrike per Klientet Familjare dhe Jofamiljare, neni 2, pika 1, mbi furnizimin e panderprere me energji elektrike te konsumatoreve tarifore.

Shoqeria CEZ Shperndarje ka kryer shkelje te pikes 3.1 te kushteve te Licenses se Shperndarjes se Energjise Elektrike dhe pikes 3.1 te Licenses se Furnizimit Publik me Pakice

Shkaqet e kryerjes se kundravajtjes konsiderohen te mesme nisur nga fakti i mungeses se modeleve organizative dhe te rregullave te menaxhimit korrekt me qellim parandalimin e shkeljeve, si dhe mungese personeli ne mirembajtjen dhe konrtollin e linjave elektrike, kryesisht kjo ne zonat rurale.

I licensuari eshte denuar me pare per kundravajtje (me ane te Vendimit 90, date 15.11.2010 dhe Vendimit 128, date 11.09.2012 te Bordit te Komisionereve te ERE), por jo per te njejten shkelje.

Pasojat e ardhura nga veprimet e shoqerise CEZ Shperndarje sh.a do konsiderohen mesatare. Kjo duke pare numrin e klienteve te perfshire dhe demin e shkaktuar konsumatoreve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë proceduren per vendosje gjobe ndaj shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.
2. Vlera fillestare e gjobes eshte ne masen 1.11 % te te ardhurave vjetore te vitit paraardhes te shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit per njoftimin e shoqerise CEZ Shperndarje per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI